



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 24.12.2020

Nr: 9

V E N D I M

P Ë R

**RREGULLAT E RAPORTIMIT TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË ÇDO
INSTITUCIONI PUBLIK, E ME KAPITAL SHTETËROR, AGJENCIVE, ENTEVE
SHTETËRORE, KATEGORITË E VEPRIMTARIVE TË NDALUARA, SI DHE
MONITORIMIN E VEPRIMTARISË, SJELLJES DHE PËRDORIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE
PARA ZGJEDHJEVE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 24.12.2020, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO	Kryetare
Arens	ÇELA	Anëtar
Dritan	ÇAKA	Anëtar
Helga	VUKAJ	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Nenet 20, paragrafi 1, germa “c”, 91 dhe 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Data: 24.12.2020

Nr. 9

Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve

1



Komisioni rregullator, në zbatim të neneve 20, paragrafi 1, germa “c”, 91 dhe 92, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Neni 12, paragrafi 4, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Neni 20, paragrafi 1, germa “c”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për miratimin e rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara përgjatë fushatës, si dhe procedurën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e ndalimit.

Neni 91, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, ka sanksionuar ndalimin e përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, duke përcaktuar kuptimin sipas ligjit, të termit “burime” dhe “burime njerëzore”. Autorizimi ligjor sipas paragrafit 5 të këtij neni, delegon kompetencën tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të nxjerrë udhëzime të hollësishme për të përcaktuar përdorimin dhe shpërdorimin e burimeve publike.

Neni 92 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, i ndryshuar, përcakton detyrimin e institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.

Autorizimi ligjor i përcaktuar në paragrafin 7, të nenit 92, delegon kompetencën tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për miratimin e aktit normativ për rregullat për shqyrtimin, kryesisht ose me kërkesë, të rasteve që mund të formojnë keqpërdorim të burimeve shtetërore, sipas pikave 1 dhe 4 të këtij neni.

PËR KËTO ARSYE:



V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij vendimi është vendosja e rregullave në funksion të marrjes së masave, monitorimit dhe parandalimit të veprimtarive të ndaluara, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore e vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës kohore 4 (katër) muaj para zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve, me synim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe të partive politike, krijimin e kushteve të drejta e të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor, si dhe për mospërdorimin e fondeve dhe të burimeve publike për qëllime partiake.
2. Objekt i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike qendrore e vendore, agjencive, enteve dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, përcaktimi i kategorive të veprimtarive të ndaluara, procedura e shqyrtimit të tyre nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për ndalimin e realizimit të tyre, si dhe masat administrative në rast të mosrespektimit të dispozitave të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të këtij vendimi.

Neni 1/1

Parime të përgjithshme

(shtuar neni “1/1”, me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

1. **Parimi i ligjshmërisë:** Procesi i raportimit të të gjithë veprimtarive me karakter publik nga Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve është detyrim ligjor. KQZ ka përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor t’i mbikqyrë, raportojë dhe ndalojë ato.
2. **Parimi i transparencës dhe informimit:** Të gjitha institucionet publike të çfarëdo niveli dhe çdo ent tjetër që kryen veprimtari publike kanë përgjegjësinë e raportimit, me transparencë dhe objektivitet për të gjitha veprimtaritë me karakter publik, brenda afateve të ligjit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve zhvillon procesin e monitorimit dhe vlerësimit me transparencë dhe e bën atë publik.

3. **Parimi i drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit:** KQZ zhvillon procesin e vlerësimit të detyrimit për raportim dhe çdo denoncim të mbërritur në KQZ mbi bazën e parimit të drejtësisë, paanësisë dhe objektivitetit. Gjithashtu KQZ duhet t'i japë rëndësinë e duhur të gjithë informacioneve të ardhura në KQZ nga të tretë dhe subjektet politikë.
4. **Parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për mos keqpërdorim të veprimtarive publike:** Të gjithë institucionet publike qendrore e vendore, që ushtrojnë veprimtari të karakterit publik si dhe KQZ e administrata e saj respektojnë të gjitha rregullat normuese që kanë të bëjnë me procesin e njoftimit të veprimtarive publike sipas afateve kohore të vendosura në Kodin Zgjedhor dhe kryejnë të gjitha procedurat që lidhen me këtë detyrim ligjor, me përgjegjësi e në përputhje me legjislacionin përkatës.
5. **Parimi i kontrollit:** Detyrimi për raportim në kohë i veprimtarive publike dhe procesi respektiv i nënshtrohet kontrollit administrativ, kontrollit gjyqësor dhe çdo kontrolli tjetër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Përkufizime

(Pas pikës “a”, të nenit 2, shtuar pikat “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, pika “c” bëhet pika “g”, ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Administratë shtetërore”, është:
 - i. administrata nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, sipas nenit 1, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përfshihen institucionet e përmendura në pikën 2, të nenit 4, të këtij ligji;
 - ii. punonjës të administratës shtetërore, ndaj të cilëve zbatohet ky vendim, sipas statusit të tyre, janë nëpunës civilë dhe punonjës administrativë, në përputhje me përkufizimet e dhëna në nenin 4, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e Punës;
 - iii. punonjës policie, punonjës të forcave të armatosura, punonjës të shërbimit informative, për sa kohë kryejnë veprimtari publike, punonjës të shërbimit të jashtëm, të përmendur në nenin 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe punonjës të tjerë, statusi i të cilëve ose elemente të tjera rregullohen me ligje të posaçme, ndaj të cilëve, përveç dispozitave të përgjithshme të këtij vendimi, do të zbatohen edhe dispozitat e veçanta për secilën prej kategorive të përmendura, për çdo rast, në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë vendim.

- b. “Institucion publik”, konsiderohet çdo organ apo ent publik në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.
- c. “Veprimtari publike” janë të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikohen të zhvillohen në periudhën 4 (katër) muaj para datës së zgjedhjeve, deri ditën e zgjedhjeve, dhe që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut dhe/ose të medias, ose pasqyrohen nëpërmjet mjeteve të tjera të komunikimit dhe të informimit publik, si të tilla por pa u kufizuar, media online, rrjete sociale, faqe interneti, etj, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim. Janë gjithashtu veprimtari të tilla dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve.
- d. “NRI” është ndërfaqja elektronike e raportimeve të institucioneve publike e cila ndërtohet dhe shërben sipas përcaktimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.
- e. “Personi përgjegjës për raportimin” është Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, sekretari i përgjithshëm i ministrisë, nëpunësi me hierarkinë më të lartë në bashki, drejtori i përgjithshëm apo drejtuesi më i lartë administrativ për agjencitë dhe institucionet nën varësinë e Këshillit të Ministrave, drejtuesi ekzekutiv i shoqërive tregtare në të cilat shteti ka pjesëmarrje në më shumë se 50 përqind të aksioneve, drejtuesi ekzekutiv i ndërmarrjeve shtetërore.
- f. “Raportim” është veprimi i informimit të KQZ nga institucioni publik mbi veprimtarinë publike të këtij të fundit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.
- g. “Kodi Zgjedhor”, është ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KREU II

KATEGORITË E VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË NDALUARA

Neni 3

Veprimtari të ndaluara

1. Në zbatim të këtij vendimi:

1.1 “veprimtari të ndaluara për tu promovuar” janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

- a) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, me interes apo shtrirje territoriale kombëtare ose vendore në fushën e transporteve të çdo lloji, të energjetikës, të telekomunikacionit, të veprave ujore të çdo lloji, në shërbim dhe interes të publikut;
- b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;
- c) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e monumenteve dhe të objekteve të paluajtshme të karakterit arkeologjik, historik, kulturor e shkencor dhe të objekte publike, ose për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të luajtshme me vlerë institucionale, historike, arkeologjike, kulturore ose shkencore;
- ç) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve strategjike, sipas legjislacionit në fuqi;
- d) mbështetjen dhe promovimin e objekteve të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

1.2 Përjashtimisht, në rastet e vendosjes së masave të jashtëzakonshme për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo epidemisë/pandemisë, nuk zbatohen përcaktimet e pikës 1.1 të këtij neni, për akte apo veprimtari të cilat synojnë marrjen e masave për përballimin e pasojave të këtyre fatkeqësive natyrore apo epidemisë/pandemisë,

Promovimi sipas pikës 1.1, të këtij neni, nuk çënon rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike në zbatim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe rastet kur ndërhyrjet me projekte përkojnë me veprimtaritë mbrojtëse në shërbim të jetës, shëndetit apo pronës.

1.3 “veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë:

- a) shpërndarjen në veprimtari publike të lejeve të legalizimeve, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;

- b) shpërndarjen në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe cfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, si dhe të regjistrimeve të titujve të pronësisë sipas ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën” në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;
- c) vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit;
- ç) përdorimin e detyruar në fushatë zgjedhore të administratës shtetërore qendrore dhe vendore brenda orarit të punës për veprimtari dhe/ose aktivitete për qëllime zgjedhore edhe me mjetet e komunikimit elektronik, si dhe përdorimin në mënyrë të detyruar dhe të organizuar brenda orarit mësimor të nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar për veprimtari dhe aktivitete në funksion të zgjedhjeve, ose premtimin apo ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari për qëllime zgjedhore, jashtë orarit të punës ose mësimin, si dhe ushtrimin e presionit ndaj tyre për këtë qëllim.
- d) gjatë fushatës zgjedhore, marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo entet publike, shtesat në organiken e çdo institucioni publik e shtetëror apo emërime provizore, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda strukturës dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti publik në përmbushje të misionit të tij. Bëjnë përjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.
- dh) kontrollet dhe verifikimet e bizneseve tregtare dhe operatoreve në kundërshtim me procedurat ligjore dhe veprimtarinë institucionale.

KREU III
NDËRFAQJA E RAPORTIMEVE DHE ADMINISTRIMI I SAJ

Neni 4

Regjistrimi i Subjekteve në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (NRI)
(ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

1. Ndërfaqja Elektronike e Raportimit të Institucioneve (NRI) përfaqëson faqen zyrtare të internetit të zotëruar dhe në shërbim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe të institucioneve të tjera për ushtrimin e detyrave e të përgjegjësisve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në këtë vendim. Ndërfaqja krijohet, administrohet dhe përditësohet nën autoritetin dhe përgjegjësinë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Çdo institucion publik krijon një llogari të vetën në NRI.
3. Llogaria në NRI krijohet personalisht nga personi përgjegjës për raportimin.
4. Për krijimin e llogarisë personi përgjegjës ngarkon në NRI, numrin e tij personal të identifikimit, datëlindjen, pozicionin që ka në strukturën administrative të institucionit publik, numër telefoni mobile, adresë e-mail, dokumentin e identifikimit të skanuar, si dhe versionin e skanuar të autorizimit të lëshuar nga drejtuesi i institucionit publik, si person përgjegjës për raportimin.
5. Në momentin e krijimit të llogarisë në NRI personit përgjegjës i shkon në numrin e tij mobile një kod numerik për të autentifikuar kërkesën për hapjen e llogarisë përkatëse.
6. Institucioni publik është përgjegjës për të dhënat që ngarkon në NRI dhe në tërësi për mbajtjen dhe administrimin e llogarisë.

Neni 5

Procedura e raportimit në NRI
(ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

1. Veprimtaria publike duhet të raportohet nga personi përgjegjës për raportimin, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
2. Raportimi i veprimtarive publike bëhet në KQZ nëpërmjet NRI e cila ndërtohet dhe mirëmbahet nga ky institucion.
3. Raportimi në NRI për një veprimtari publike të caktuar duhet të bëhet jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. Raportimi bëhet për veprimtari të cilat organizohen,

ose bashkëorganizohen nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë.

4. NRI mund të lejojë raportimin e një veprimtarie e cila nuk plotëson kushtin e pikës 1 të këtij Kreu, por automatikisht kjo veprimtari përcaktohet si e ndaluar për sa kohë KSHZ nuk ka marrë një vendim për ta lejuar atë.
5. Raportimi duhet të përmbajë, datën dhe orën e zhvillimit të veprimtarisë, qarkun, bashkinë adresën ku ajo zhvillohet, llojin e saj, qëllimin dhe tematikën e veprimtarisë, emër mbiemër të personave pjesëmarrës të cilët përfaqësojnë nivelin më të lartë hierarkik shtetëror në aktivitetin përkatës, institucionin të cilit i përkasin, emër mbiemër të folësve të mundshëm dhe pozicionin e tyre, me pjesëmarrje të medias ose jo, pasqyruar në rrjete sociale, median online, ose jo.
6. Të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën 5 (pesë) ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij.
7. Të dhënat mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore, apo të institucioneve publike duhet të jenë të aksesueshme, “open data,” për këdo të tretë, direkt nga NRI, duke patur mundësinë e prodhimit të raporteve përkatëse. Informacioni që përmban NRI është i aksesueshëm nga momenti i hedhjes së të dhënave deri në datën e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

KREU IV

PËRDORIMI I BURIMEVE NJERËZORE, FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE PARA DHE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e punonjësit e administratës shtetërore

1. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë periudhës zgjedhore, i krijohen kushtet e nevojshme dhe i garantohet moscenimi i të drejtave dhe lirive kushtetuese për të ushtruar pa ndikim lirinë e shprehjes dhe/ose për të marrë pjesë në veprimtari politike, brenda kufizimeve dhe ndalimeve, të përcaktuara me dispozita të veçanta të legjislacionit në fuqi dhe në këtë vendim.
2. Punonjësi i administratës shtetërore i cili është regjistruar si kandidat për zgjedhjet pezullohet nga detyra nga momenti i regjistrimit të tij si kandidat deri në datën e përfundimit të numërimit të votave në zonën ku kandidon. Për nëpunësit, marrëdhënia e punës të të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës, në rastet kur nuk njoftojnë për kandidimin në zgjedhje, merret masa e ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

3. Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdo lloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje.
4. Punonjësi i administratës shtetërore, vetëm pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore, ka të drejtë të marrë pjesë në veprimtari politike apo zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
5. Gjatë pjesëmarrjes në veprimtari politike apo zgjedhore, nëpunësit civil, i ndalohet të shprehë publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat.
6. Ndalohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore i administratës shtetërore të institucionit, nëpërmjet ushtrimit të presionit ndaj tyre për këtë qëllim, si dhe premtimit ose ofrimit të përfitimeve nëpunësve publikë, për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës.
7. Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar zyrtarisht eprorin direkt dhe njësinë e burimeve njerëzore për këtë veprimtari. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmbushjen e detyrave funksionale, në përputhje me Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”.

Neni 7

Detyrat e sekretarëve të përgjithshëm dhe drejtuesve të institucioneve publike, të pavarura e të varësisë

1. Sekretarët e përgjithshëm të institucioneve publike qendrore e vendore, të pavarura e të varësisë, kryetarët e bashkive, prefektët, drejtuesit e njësive administrative dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë:
 - a) organizojnë menjëherë punën dhe marrin masat e nevojshme për garantimin e zbatimit të detyrimeve ligjore, për ndalimin e vënies në përdorim për subjektet zgjedhore të veprimtarisë së tyre institucionale, mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, pronë e Institucioneve shtetërore/publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror e vendor;

- b) kontrollojnë në mënyrë periodike veprimtarinë e nëpunësve dhe punonjësve nën varësinë e tyre, me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje.
- c) publikojnë të dhënat e tyre të kontaktit në faqen zyrtare përkatëse të internetit, me qëllim administrimin e çdo denoncimi dhe të çdo rasti të përfshirjes, nxitjes, urdhërimit, shantazhimit apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të atij institucioni në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor apo të kandidati në zgjedhje.
- ç) verifikojnë dhe analizojnë të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale dhe marrin masa për përcjelljen e denoncimeve sipas rastit, në KQZ ose Prokurori.
- d) marrin masa që automjetet si dhe karburanti, në përdorim të titullarit apo institucionit, të ndalohen të përdoren për veprimtari politike e të fushatës zgjedhore, të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje, duke urdhëruar parkimin e detyruar të automjeteve në mbarim të orarit zyrtar në ambientet e institucioneve respektive. Bën përjashtim nga ky ndalim përdorimi i automjeteve të dedikuara zyrtarëve të lartë, Shërbimit të Protokollit të Shtetit, të Gardës së Republikës, atyre në shërbim të Policisë së Shtetit, në përmbushje të detyrave të tyre funksionale, si dhe rastet e urdhëruara me autorizim për shërbime pune;
- dh) marrin masa për ndalimin e iniciativave elektorale ndikuese, diktuese dhe urdhëruese apo të propagandës politike, në funksion të fushatës zgjedhore, në institucionet publike përkatëse;
- e) marrin masa dhe realizojnë monitorimin e zbatimit të tyre, për të penguar keqpërdorimin dhe garantuar mospërdorimin e:
- i) burimeve njerëzore të institucionit në funksion të veprimtarisë elektorale e të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
 - ii) fondeve të institucioneve për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;
 - iii) mjeteve dhe materialeve në inventar të institucionit për periudhën 4 muaj përpara deri në datën e zgjedhjeve, në funksion të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore;
 - iv) institucioneve publike për zhvillimin e fushatës zgjedhore apo realizimin e propagandës politike në to;

v) veprimtarisë shtetërore për të favorizuar subjekte të caktuara zgjedhore;

Neni 8

Detyrat e komisionerit për shkeljet e konstatuara dhe raportuara gjatë fushatës zgjedhore

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në rastet kur, kryesisht ose me informacion të paraqitur nga të tretët, konstaton shkelje të detyrimeve të përcaktuara në këtë kre, paralajmëron me shkrim partinë politike, subjektin zgjedhor apo kandidatin në favor të të cilit është kryer veprimtaria e punonjësit, duke i kërkuar ndërprerjen e kësaj veprimtarie dhe marrjen e masave për mospërsëritjen e saj në të ardhmen. Paralajmërimi njoftohet publikisht edhe në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

KREU V

VENDIMMARRJA E KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE

Neni 9

Shqyrtimi i Raportimeve dhe ndalimi i veprimtarive publike

(ndryshuar me vendimin nr. 16, datë 21.12.2024)

1. KQZ shqyrton raportimet e institucioneve si rregull jo më vonë se 3 (tre) ditë nga raportimi i tyre në NRI.
2. Në rast se KQZ, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton se veprimtaria publike përbën veprimtari të ndaluar, urdhëron ndalimin e zhvillimit të veprimtarisë publike përkatëse. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në NRI, në pjesën që i takon veprimtarisë. Njoftimi për ndalim i shkon automatikisht institucionit në llogarinë e tij në NRI.
3. Personat e tretë që paraqesin kërkesën në KQZ për të kërkuar ndalimin e një veprimtarie publike, duhet ta paraqesin atë jo më vonë se 3 (tre) ditë nga data e planifikuar e mbajtjes së tij. Kërkesa paraqitet në protokollin e KQZ ose nëpërmjet adresës zyrtare të e-mailit dhe duhet të jetë e arsyetuar. KQZ shqyrton kërkesën dhe vendos në lidhje me të brenda 24 orësh nga paraqitja e saj.
4. Për veprimtarinë ose aktivitetin publik “Ndaluar nga KQZ-ja”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve njofton menjëherë zyrtarisht edhe Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Veprimtaritë e ndaluara nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk lejohen të transmetohen apo të pasqyrohen në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizione. Transmetimi ose pasqyrimi i tyre në kundërshtim me ndalimin e vendosur nga Komisioneri ngarkon me përgjegjësi transmetuesin radioteleviziv.

5. Mosraportimi i një veprimtarie publike, ose raportimi i saj në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në këtë vendim, apo akte të tjera, apo pengimi për raportim, ngarkon me përgjegjësi personi përgjegjës në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Shqyrtimi administrativ në këtë rast bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe aktet e KQZ.

Neni 10

Sanksionet administrative

1. Në rastet kur subjektet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, të këtij vendimi, nuk raportojnë, raportojnë pjesërisht ose zhvillojnë veprimtarinë, pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kur shkelja nuk përbën veprë penale, dënohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 3000 (tremijë) deri në 90 000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, sipas nenit 171, pika 1, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Në rast se Komisioneri konstaton se Titullari i institucionit ka penguar raportimin sipas këtij vendimi, ka ndikuar apo urdhëruar që ai të raportohet me vonesë, apo veprimtaria apo aktiviteti publik është zhvilluar pavarësisht ndalimit të bërë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, titullari i institucionit ndëshkohet nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me gjobë nga 10 000 (dhjetë mijë) deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë sipas nenit 169, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e vendimit të gjobës së dhënë në bazë të këtij neni. Gjoha e vendosur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet sipas procedurave të parashikuara në nenin 510, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 11

Ankimi ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ndalon realizimin e veprimtarisë publike ose vendimit të ndëshkimit me gjobë mund të behet ankimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, përkatësisht, brenda 3 (tre) ditësh nga shfaqja e shënimit “Ndalur nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimeve ose marrja dijeni për gjobën.

Neni 12

Institucionet që ngarkohen për zbatim

1. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, të pavarura e të varësisë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi si aneks 1.
2. Ngarkohet administrata e KQZ-së të bëjë përditësimin vijues të kësaj liste.

KREU VI

ANKIMI DHE HYRJA NË FUQI

Neni 13

Ankimi

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana	NANO	Kryetare
Arens	ÇELA	Anëtar
Dritan	ÇAKA	Anëtar
Helga	VUKAJ	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ	Anëtar